

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA DIMAL  
KËSHILLI BASHKIAK

**Procesverbal**

**Mbledhja e radhës e Këshillit Bashkiak Dimal**

**Mbajtur më date 26.12.2023**

Ora e hapjes së mbledhjes 14:00, vendi i mbajtjes së mbledhjes në Njësinë Administrative Poshnje kati i I-rë salla e mbledhjeve e Këshillit të Bashkisë Dimal. Mbledhja e radhës e Këshillit të Bashkisë Dimal e hapur.

Listë prezenca e këshilltarëve pjesmarrës në momentin e hapjes së mbledhjes.

1. Anila Shahini
2. Adelina Vangjeli
3. Avdulla Salillari
4. Bajame Mjelli
5. Bukuroshe Goga
6. Gerta Kumaraku
7. Hysen Hoxha
8. Julian Kora
9. Lorenc Plaku
10. Luto Goga
11. Petref Sula
12. Petro Tumani
13. Razije Baho
14. Saljon Hoxha
15. Shkelqim Tafa

U deklarua korumi prej 15 Këshilltarësh

Në mbledhje janë të pranishëm përfaqësues të administratës të cilët kanë hartuar projekt vendimet që do të merren në shqyrtim.

Kryetari i Këshillit deklaroj hapjen e mbledhje.

**Pika 1 e rendit të ditës:** Miratimi i rendit të ditës.

**B.Mjelli:** Kemi një material të cilin e kemi diskutuar në mbledhjen e Komisionit të Ekonomisë dhe kemi qënë dakort që ta përfshijmë në axhendën e ditës së sotme, vlrën e kompesimit të energjisë elektrike.

A.Salillari: Hidhet në votim dhe miratohet me 15 Vota Pro nga 15 Këshilltarë Prezentë.

A.Hoxha: Kemi një material i cili është sjell sot ju informoj se ka ardhur një shkresë nga Ministria e Financave, mbi zbatimin e aktit normativ nr 6 datë 14.12.2023 ku akordohet një transfertë e pakushtëzuar për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura për Bashkinë Dimal. A mund ta përfshijmë këtë pikë në axhendën e ditës.

A.Salillari: Hidhet në votim dhe miratohet me 15 Vota pro nga 15 Këshilltarë prezentë.

**Pika 2 e rendit të ditës:** Miratimi i Proces-verbalit të mbledhjes së kaluar.

A.Salillari: Hidhet në votim, miratohet me 15 vota Pro nga 15 këshilltarë Prezentë.

**Pika 3 e rendit të ditës:** Mbi miratimin e ndihmës nga fondi i kushtëzuar 6% për 10 familje me fond 58.547 lekë për Muajin Nëntor 2023.

M.Tomani: Sektori i Ndhmës Ekonomike propozon për muajin Nëntor trajtim me ndihmë ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6%, familjet janë të referuara nga sistemi për të qënë përfitues të skemës.

A.Salillari: Hidhet në votim, miratohet me 15 Vota pro nga 15 Këshilltarë prezentë.

**Pika 4 e rendit të ditës:** Trajtimi me ndihmë ekonomike sipas listës emërore bashkëlidhur për 106 familje nga Fondi i Bashkisë në shumën 272.000 lekë për Muajin Nëntor 2023.

M.Tomani: Në mbështetje të ligjit “ Për Ndhmë dhe Shërbime Shoqërore “ ligji nr 9355 datë 10.03.2005 si dhe VKM-së për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave dhe masës së përfitimit për ndihmë ekonomike, Sektori i Ndhmës Ekonomike propozon për muajin Nëntor 2023 për trajtim me ndihmë ekonomike nga Fondi i Bashkisë 106 familje me një fond prej 272.000 lekë. Familjet janë përzgjedhur nga administratoët dhe rekomanduar nga drejtori i Ne-së duke u bazuar në kriteret e miratuara me vendim këshilli.

A.Salillari: Hidhet në votim dhe miratohet me 15 Vota pro, nga 15 këshilltarë prezentë.

**Pika 5 e rendit të ditës:** “ Mbi miratimin e bursave nga buxheti i shtetit për nxënësit e vitit të parë në shkollat e mesme profesionale”.

R.Hoxha: Sektori i Arsimit Kulturës dhe Sporteve bazuar në VKM-në Nr.666 datë 10.10.2019 “ Për kuotat financiare të ushqimit në menca dhe konvike dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”, realizoi njoftimin e nxënëseve për fillimin e procedurave të aplikimit për trajtimin me bursë nga fondi i buxhetit të shtetit të bursave për nxënësit duke publikuar kriteret e përfitimit të bursave si dhe dokumentacionin e nevojshëm që duhet të pëloësojnë për të përfituar bursë.

Në total janë paraqitur 14 aplikime nga Njësitë Administrative dhe shkollat e mesme profesionale.

H.Hoxha: Sa është numri i bursave i akorduar për vitin shkollor 2023-2024?

R.Hoxha: Është 15 bursa, në total kemi 14 aplikime.

A.Salillari: Hidhet në Votim, Miratohet me 15 Vota pro nga 15 këshilltarë prezentë në mbledhje.

**Pika 6 e rendit të ditës:** “ Për miratimin e vlerës së kompesimit të Energjisë Elektrike për ambientet private të cilat funksionojnë si kopësht/shkollë për tu përdorur për nevoja të Bashkisë Dimal.

B.Mjelli: Kryetare e Komisionit të Ekonomisë kjo pikë u diskutua dhe në mbledhjen e Komisionit të Ekonomisë dhe ishim dakort që ta fusim në rendin e ditës.

R.Hoxha: Sektori i Arsimit Kulturës dhe Sporteve në zbatim të ligjit për “Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar, ju vë në dijeni se është e nevojshme miratimi i vlerës për kompesim të energjisë elektrike për ngrohje në ambientet private të cilat përdoren në funksion të ambienteve arsimore të Bashkisë Dimal. Duke qënë se jemi në muajt e dimrit në ambientet arsimore është e nevojshme sistemi i ngrohjes në këto ambiente pasi nuk mund të përshtaten me soba druri dhe ka funksionuar me ngrohje me energji elektrike ( rezistencë, kalorifer).

Ambienti i marrë me qera në fshatin Donofrosë ka gjithsej 62 nxënës, kopshti Rërez ka 33 fëmijë. Pagesa për kompesimin e energjisë elektrike për ngrohje do të paguhet me afat 1 vjeçar.

A.Salillari: Hidhet në Votim dhe miratohet me 15 Vota pro nga 15 këshilltarë Prezentë në mbledhje.

**Pika 7 e rendit të ditës:** “ Për shtesë buxheti viti 2023”.

A.Hoxha: Para miratimit të rendit të ditës, kjo është një ndër pikat që u fut në rendin e ditës.

M.Bizdani: Bazuar në shkresën që na ka ardhur nga Ministria e Financave dhe e Ekonomisë nr 22656/6 datë 20.12.2023 protokolluar në Bashkinë Dimal me nr 56/12 prot datë 22.12.2023 Bashkisë Dimal i akordohet shtesë fondi transfertë e pakushtëzuar në strukturën buxhetore në masën 19.886.473 lekë. Përdorimi këtij fondi do të bëhet për likuidimin e detyrimeve të prapambetura.

A.Salillari: Hidhet në Votim dhe miratohet me 15 Vota pro nga 15 këshilltarë prezentë në mbledhje.

**Pika 8 e rendit të ditës:** “ Për miratimin e zbatimit të planit social 2024-2026”.

Në këtë pikë të rendit të ditës , vjen Z.Ardit Tafa Anëtar i Keshillit.

F.Agalliu: Plani Social 2024-2026 është hartuar mbi bazën e një analize të gjerë të situatës së grupeve në nevojë për shërbime në tërëtorin e Bashkisë, shërbimeve ekzistuese si dhe kapaciteteve njerëzore e financiare të këtij institucioni për t’ju përgjigjur cilësisht nevojave për shërbime të mbrojtjes e përkujdesit social në territorin e saj. Në procesin e hartimit të Planit u përfshinë institucione lokale dhe organizata partneritetin me të cilat Bashkia Dimal synon ta thellojë më tej gjatë zbatimit të këtij plani.

Plani social ka specifikuar për çdo aktivitet treguesit që bëjnë të mundur monitorimin e zbatimit të aktiviteteve specifike kohën e zbatimit si dhe strukturën përgjegjëse për monitorim.

Sh.Tafa: Kjo tabela e buxhetit është hartuar nga ju apo nga financa?

F.Agalliu: Është hartuar nga Financa.

M.Bizdani: Pagat e secilit punonjës të shërbimit social është përfshirë në buxhetin e Bashkisë.

Kryetarja: Nëse ka përplasje me VKM-në e miratuar pagat do të përshtaten sipas sipas VKM-së që është në fuqi pjesë e buxhetit.

A.Salillari: Hidhet në votim dhe miratohet me 16 Vota Pro nga 16 Këshilltarë Prezentë.

**Pika 9 e rendit të ditës:** “ Mbi miratimin e planit të punës të Këshillit Bashkiak Dimal për vitin 2024”.

A.Hoxha: Referuar rregullores së funksionimit të Këshillit Bashkiak Dimal dhe tematikave të cdo drejtorie dhe sektori paraqiten për shqyrtim gjatë një viti kalendarik. Është hartuar plani i Punës së Këshillit Bashkiak Dimal për Vitin 2024 i cili përbëhet nga ai i konsultimit publik, plani i vendimarrjes, dhe buxheti i Keshillit.

Plani i Punës ka në përbërjen e vet një plan aktivitesh mujore bazuar në rregullore dhe ligje. Në muaj të ndryshëm janë parashikuar edhe tema të rëndësishme sic janë tema mbi mjedisin mbi barazin gjinore, si dhe informacione të ndryshme nga drejtoritë.

Në këtë plan përfshihet mbështetja financiare e tij e pasqyruar në PBA 2024-2026 si dhe tematika e tij sipas muajve përkatës, gjithashtu përfshihet edhe detajimi i këtij buxheti vjetor sipas zërave në materialin përkatës. Miratohet me 16 Vota Pro.

**Pika 10 e rendit të ditës:** “ Mbi miratimin e kalendarit për hartimin e projekt-buxhetit afatmesëm 2025-2027”.

M.Bizdani: Bazuar në ligjin Nr.68/2017 “ Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore” neni 33 pika 2 e ligjit është një detyrim ligjor hartimi dhe miratimi i kalendarit të buxhetit afatmesëm.

Këto etapa janë detyrime ligjore për zbatim duke startuar në shkallë hiarkike e duke proceduar me të gjithë drejtuesit e programeve buxhetore. Ky kalendar tregon hapat që duhet të ndjekë administrata e Bashkisë referuar ligjit për hartimin e këtij projekt-buxhetit. Kalendarit kalon në disa faza e cila cdo fazë e tij hap pas hapi miratohet nga Këshilli Bashkiak. Hapi i parë është miratimi i kalendarit dhe më pas me radhë.

A.Salillari: Hidhet në votim dhe miratohet me 16 Vota Pro nga 16 Këshilltarë Prezentë në mbledhje.

**Pika 11 e rendit të ditës:** “ Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Dimal për vitin 2024 dhe PBA 2024-2026”

Kryetarja: Me hartimin e këtij buxheti të mbushim të gjitha detyrimet ligjore, patjetër që kemi nevojë për më shumë por jemi përpjekur të kemi një zë të vecantë në vlerësimin e buxhetit.

Nga kjo kemi ndjekur në parim që granti që vjen i pakushtëzuar nga qeveria të shkojë për investime. Vitin që vjen do apikojmë dhe ne rritjen e pagave kalojmë në nivelin maksimal të pagave të cdo punonjësi, mendoj që punonjësi duhet motivuar në këto ditë të vështira në inflacion.

Ne jemi përpjekur gjithmonë të kemi një gjithëpërfshirje të komunitetit pra buxheti të përfshijë cdo cep të territorit tonë. Në relacion ne kemi një bllok të gjerë të punëve të cilat do të realizohen ato rrugë fshatrash të cilat kemi marrë një miratim paraprak për financim nga fondi i zhvillimit. Një zë të vecantë do të ketë edhe hartimi i planit strategjik të zhvillimit të bashkisë Dimal, një plan i cili jemi përpjekur që ta realizojmë ato problematika që kanë qënë emergjenca për territorin dhe domosdoshmëri ka qënë në vizionin tonë, pothuajse nuk kemi më përmbetje në lumin Osum. Këtë vit do bëjmë një mirëmbajtje në

shkolla me investime. Por që ne të kemi një përfaqëzim dinjetoz duke qënë se i kemi ezauruar këto problematika emergjencia dhe mendoj se është e rëndësishme një godin e re bashkëkohore të cilën e kemi bërë pjesë e këtij buxheti. Edhe sporti ka zënë një vend të posaçëm në buxhetin tonë, ngritjen e ekipit të Osumit, falë dhe vendimarrjes tuaj të cilën e kaluam në shoqatë ngritjen e këtij ekipi i cili na ka nderuar në gara.

Sh.Tafa: Tek arsimi për mirëmbajtje shkollash, por nuk shoh investime, projekt për cerdhen ku fenomeni i dhunës ndaj fëmijëve nëpër cerdhe është bërë e vështirë në ditët e sotme? Për tregjet që paguajnë taksa nuk shoh ndonjë investim? Taksa e tokës dhe taksa e biznesit të vogël të rishikohet? Për kalanë e Dimalit administrimi i hapësirave publike?

Kryetarja: Ashtu sic e thamë dhe në fillim ka vend për më shumë por gjithmonë financat janë të cinguara sesa janë nevojat ne jemi përpjekur për cdo njësi administrative. Pjesa e tregjeve vërtë është një, ne projektet i kemi hartuar. Për tregun e Poshnjes ne kemi bërë një aplikim pranë AZHBR-së sepse në relacion nuk kemi folur për projektet që kemi për aplikim. Fole që ne nuk kemi hartuar për Dimalin, ne kemi hartuar së fundmi hartimin e planit strategjik të zhvillimit që do të hartohet 6 muajt e parë të vitit që vjen. Jemi duke bashkëpunuar me Universitetin Polis për projektet drejt finalizimit pa financa. Rishikimin e disa tarifave e kaliam në mbledhjen e muajit të kaluar, taksa e tokës është një taksë kombëtare e parashikuar nga ligji me taksat kombëtare.

A.Salillari: Hidhet në Votim, miratohet me 16 Vota Pro nga 16 Këshilltarë Prezentë.

Të ndryshme: “Mbi propozimin e Antarit të Këshillit për të ndihmuar familjen e Z.Leonard Gjoni me fond ndihmë 100.000 lekë. Familja e Z.Leonard Gjoni banorë e lagjes “18 tetori” Ura Vajgurore përbëhet nga 4 antarë. Pak kohë më parë kjo familja e ka përjetuar një fatëkqësi të madhe duke humbur bashkëshorten Etleva Gjoni e cila duke shkuar në punë pëson arrest kardiak një mësuese e nderuar e Komunitetit të Bashkisë Dimal. Humbja e nënës dhe dhimbja që shkaktoi te fëmijët është e thellë duke krijuar jo vetëm vështirësi ekonomike por edhe prishje të situatës dhe qetësi familjare. Për ta ndihma është një mbështetje në këtë moment që të ndiejnë dorën e ngrohtë dhe solidaritet për të përballuar situatën.

A.Salillari: Hidhet në votim dhe miratohet me 16 Vota pro nga 16 Këshilltarë prezentë.

L.Plaku: Unë mendoj se ne si këshill ti drejtojmë një shkresë Ujësjiellës Kanalizimeve , që cila është problemi dhe kur merr zgjidhje. Problematika qëndron në mos furnizimin me ujë të lagjes “18 Tetori” në 24 orë ndryshe nga lagjet e tjera që furnizohen me ujë 24 orë pra lagja “28 Nëntori” dhe “4 Shtatori”.

Të gjithë këshilltarët jane dakort nuk kanë kundërshtime le të bëhet kjo kërkesa dhe ti dërgohët Ujësjiellës Kanalizime Berat Sh.a.

A.Salillari: Hidhet në votim dhe miratohet me 16 Vota Pro nga 16 Këshilltarë Prezentë.